



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI



Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 45 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 9.1 të Rregullores për mbajtjen e mbledhjes të Kuvendit të Komunës dhe organeve të tij, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë

Ju fton

të merrni pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më **27.10.2011 (e enjte) me fillim në ora 10:00**. Mbledhja do të mbahet në Sallën e Kuvendit të Komunës në Vushtri.

Për këtë mbledhje propozohet ky:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.
2. Shqyrtimi i raportit për situatën ekonomiko-financiare dhe për realizimin e planeve investuese për periudhën Janar-Shtator 2011.
3. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e vitit shkollor 2010/2011 dhe përgatitjet për vitin shkollor 2011/2012.
4. Shqyrtimi i Draft-rregullores për mbrojtjen e mjedisit (shqyrtimi i parë).
5. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim me kompensim të pronës së paluajtshme të komunës-tokës bujqësore dhe kullotat.
6. Shqyrtimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së bizneseve në Komunën e Vushtrrisë.
7. Shqyrtimi i propozim-vendimit për caktimin e ditës festive "Dita e Patates".
8. Shqyrtimi i propozim-vendimit për lejimin e mjeteve për transportimin e nxënësve të këtyre fshatrave: Kollë, Gumnishtë, Karaçë, Mihaliq dhe Liqej.
9. Shqyrtimi i propozim-vendimit për sigurimin e mjeteve për transportimin e nxënësve për këto shkolla: "Liria", "Azem Bejta" dhe "Andon Zako Çajupi".
10. Shqyrtimi i Planit të Veprimit për përmirësimin e shërbimeve publike.
11. Të ndryshme.

Bashkangjitur iu dërgojmë materialet për të gjitha pikat e rendit të ditës për këtë mbledhje të KK-së, përveç për pikat 9 dhe 10, për të cilat materialin e keni marrë në mbledhjen e kaluar të KK-së.

Kryesuesi i Kuvendit
Ferit Idrizi